

INTERVISTË ME FLAMUR GASHIN

Prishtinë | Data: 23 janar, 2016

Kohëzgjatja: 72 minuta

Të pranishëm:

- Flamur Gashi (I intervistuari)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: Prezantohuni, edhe a kishit mujtë me na folë për kujtimet e hershme t'fëminisë, familjen, vendlindjen?

Flamur Gashi: Unë jam Flamur Gashi, i lindur dhe i rritur deri në një farë moshe në Pejë. Pastaj vazhdojnë vitet jetësore jashtë Pejë. Kam lindur në Pejë, në një familje të mesme. Baba im ka qenë mësues, nana ka qenë amvise. Jemi gjashtë fëmijë në familjen tonë: tre vëllezër dhe tri motra. Kemi kaluar peripeci të jetës si shumica e shqiptarëve në Kosovë.

Historia e familjes është pak ma interesante, pak ma ndryshe, për t'mos thanë ma interesante, pak ma ndryshe se e tjerëve. Im at' ka lindë në Shqipëri, nëna ime ka lindë në Pejë. Fëmijtë e mi kanë lindë në Shqipëri, unë kam lindë në Pejë, gruaja ime ka lindë në Shqipëri. Kështu që është një kombinim i bukur në mes Shqipërisë zyrtare dhe trojeve shqiptare jashtë Shqipërie dhe Kosove.

Sipas t'gjitha gjasave, origjina e familjes time duhet t'jetë nga Nishi, por dikund nga vitet 1785- 86, kur ka qenë një dyndje e madhe e shqiptarëve nga dhuna dhe represioni serb, kanë lëvizur dhe kanë ardhur në pjesën, po themi qendrore shqiptare, dikund në rrethinat e Pejës, në Bajë të Pejës dhe në Pejë, për t'pasë lëvizjen permanente pastaj në mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Ne në Kosovë jemi vetëm gjyshi im me fëmijtë e tij pra, dhe vëllau i gjyshit. Kushëritë e parë i kemi në Shqipëri, që kanë jetuar gjithë kohën atje. Për këtë arsye edhe babai im është i lindur në Shqipëri,

sepse kemi pasë shpinë dhe kemi jetuar atje. Ndryshimi pastaj ka ndodhë se edhe unë kam shku pas vitit '90 menjëherë në Shqipëri dhe jetoj e punoj në Shqipëri.

Fëmijërinë e kam kaluar në mes të fshatit Ruhot në Pejë dhe Pejës. Shkollën tetë vjeçare e kam kryer në fshat, në Ruhot pas shumë peripecive, sepse na u ka dashë që... pas vitit '45 neve na kanë marr gjithë pronën që e kemi pasë n'qytetin e Pejës, dhe kemi jetuar në një gjendje jo t'mirë materiale. Kemi gjetë strehim përreth pesë vite në një fshat afër Banjës të Pejës, te kushëritë tanë pak ma t'largët por që na kanë ndihmuar, për t'ardhur dikun rreth fillim viteve '50 në një fshat që quhet Ruhot në Pejë, për t'jetuar në kushte tepër t'vështira, në një shtëpi të serbëve, ku gjyshi im me gruan dhe fëmijtë e vet punonin për të *tretë*¹ quhej atëhere se punonin për pronarin që ishte serb, dy hise t'ia japin atij të tokës dhe një ta marrin për vete, për mbijetesë.

Pra ka qenë një luftë e jashtëzakonshme për mbijetesë. Në moshën fëmimore babait tim i ka vdekë nana kështu që është rritë me shumë peripeci, vështirësi. Ka vazhduar shkollën, është njohur me nënën time, është martuar me të. Dhe n'vitin '69 kam lindur unë.

Erëmirë Krasniqi: A jeni më i madhi ju?

Flamur Gashi: Unë jam fëmija i madh i familjes. Edhe këtu fillojnë peripecitë, sepse pak kohë para se t'lindja unë babai im ka ra n'burg. Ka qenë njëri nga organizatorët e demonstratave të vitit 1968 në Pejë, së bashku me miqtë e tij, shoktë e tij të ngushtë: profesor Isa Demaj, Ramadan Blakaj, Zymer Neziri dhe të tjerë. Dhe nga ai moment... fati është kështu ndoshta i destinuar. Unë e gëzoj edhe emrin Flamur sepse babai kishte ra n'burg për flamurin. Pastaj edhe nana ime ma vuri emrin Flamur dhe kjo peripeci m'ka ndejkë pastaj që nga viti '69 kur kam lindur, deri n'fund t'viteve '90 n'fillim t'viteve'91, kur kam ikë nga Kosova.

Ka qenë një jetë jo e lehtë, goxha e vështirë, për t'mos thanë shumë e vështirë, se shumë shqiptarë t'Kosovës e kanë pasë jetën shumë ma t'vështirë se unë. Kështu që është keq t'i marr meritat dhe t'them që jeta ime ka qenë e vështirë, por s'ka qenë aspak e lehtë. Kështu ka vazhdu jeta fëmimore e imja.

¹ *Tretë*, ta punosh tokën e tjetrit, dhe ti korrësh 1/3 e fitimit.

Babai im ka qenë mësues dhe pas vitit 1972, atëherë u mor një vendim në Komitetin Krahinor të Kosovës se njerëzit t'cilët janë dënuar politikisht t'mos të kenë të drejtë të punojnë n'arsim, dhe babait tim iu hoq e drejta për t'punuar n'arsim. Këte për t'theksuar se babai im ka qenë një gjeneratë me ish-presidentin e Kosovës dhe shok shkolle me presidentin e Kosovës, Ibrahim Rugova. Dhe praktikën e parë si mësues e kanë ba dikun në Obiliq së bashku, si mësues të gjuhës shqipe, me disa mësues të tjerë që kanë dalë n'atë kohë. Sa është kthyer, e kanë heqë nga arsimi. Dhe nga ajo kohë ka punuar në një organizatë që merrej me erozionin dhe përmbytjen, një kohë quhej "Buica" e pastaj "Erozioni", ndërmarrja "Erozioni" në Pejë.

Kështu që filloi edhe jeta e re e fëmive. Unë fëmija i parë n'familje, deri te fillimi i shkollës në shkollën tetë vjeçare "Rilindja" në fshatin Tërstenik të Pejës. Aty kam kry shkollën tetë vjeçare, për t'përjetuar peripecitë e para n'familje, se n'vitin 1979, '80, '81, '82, '83 dhe '84 babai im është arrestuar çdo fillim pranvere. Quhej izolim n'atë kohë, dhe i kam përjetuar si fëmi dhe n'prag adoleshence të gjitha teroret.

Erëmirë Krasniqi: Me çfarë preteksti?

Flamur Gashi: Ka qenë një pretekst atëhere se këta që llogariteshin si kundërshtarë të sistemit jugosllav duhej t'izoluuar, se bënin t'këqija, duhej izolu sepse... n'vitin '79 ka qenë në Gjermani, e kam pasë axhën në Gjermani, se n'vitin '68 ka shku axha në Gjermani, i cili na ka ndihmu që t'blejmë prona, ato prona që n'fillim ne punonim me të *tretë*, i kemi ble pastaj nga serbët të gjitha, i kemi ba prona tona. Dhe jemi ba pronarë t'gjithë asaj pasurie, rreth pesë-gjashtë hekarë tokë, shpi e madhe, por me ndihmën e xhaxhait që ish' në Gjermani edhe babës që punonte.

Baba ka shku me vizitu vëllaun e vet në Gjermani, se është lënduar në punë, normalisht si bënin shqiptarët punë të ndryshme në ndërtim, dhe atje ka takuar shokun e vet t'ngushtë t'shkollës t'mesme, Jusuf Gërvallën. Dhe këtu e ka marr vesh policia edhe e kanë arrestu n'aeropot në vitin 1979, sa është kthy nga Gjermania. Pastaj ka fillu izolimi, jo vizita e Titos në Kosovë, jo ku di unë se çfarë, por çdo pranverë nga viti 1979 është arrestuar.

Në vitin '84 është arrestuar për herë të fundit. Ka qenë një moment tepër i vështirë i imi, moment që nuk kam shumë dëshirë shpesh edhe me kujtu, sepse babai ka qenë duke shkuar me tre shokë të vet në varrim të një miku të tyre në Gjakovë, zotrit Kadri Kusari, i cili ka qenë njëri ndër personalitetet e njohura shqiptare i cili ka kontinuar jashtëzakonisht shumë në të gjithë Kosovën. Ka qenë i burgosur

në vitin 1964 me grupin e Adem Demaçit. Një personalitet i njohur, ka vdekë në fund janarin e vitit 1984. Këta kanë qenë duke shku n'varrim, i kanë ndalu, i kanë arrestu, nuk i kanë lanë me shku atë ditë në varrim, vetëm t'iu bënëin presion.

Po përsëri kanë vendosë, të nesërmen babai im... ka qenë Nezir Gashi, një personalitet i njohur n'rrafshin e Dukagjinit, një patriot i jashtëzakonshëm, ka qenë Sadri Tafilaj, një profesor i matematikës i cili për një kohë t'gjatë ka jetuar në Gjermani edhe ka qenë zoti Sefer që ka qenë kasap në Pejë, por kanë qenë me makinën e tij, një mik i tyre t'cilin e kanë arrestu dhe nuk e kanë lanë për të shku në Gjakovë. Po t'nesërmen prapë, iu kanë thanë, “Mos gaboni me shku!” Janë kthy mbrapshtë, kanë shku në Gjakovë, kanë thanë, “Na kemi ardhë për vorrim.” “Po është vorrosë dje.” “Ndjesë, po neve na ka arrestu policia. Po ne do t'shkojmë sot”.

Kanë shku te varri i tij, kanë vu një buqetë me lule aty. Të nesërmen n'mëngjes, jemi zgju n'mëngjes, kemi pa shtëpinë n'gjitha anët t'rrethuar me polici, dhe atë ditë e kanë arrestu babain tim. Ka qenë fillim shkurti i vitit '84, dhe pas 28 ditësh m'kanë thirrë mu n'polici për tu takua me babain tim, për tu ballafaquar. Ishte presion psikologjik ndaj tij. Dhe unë pas 28 ditëve e kam pasë shumë të vështirë ta identifikoj babain tim, nga rrahjet dhe turturat që i kishin ba.

Erëmirë Krasniqi: Sa ka nejtë n'burg t'qatë periudhë?

Flamur Gashi: N'atë kohë ka ndejtë rreth katër muj me sa e mbaj n'mend, tre muj e gjysë, katër është liruar, dhe fatkeqësisht babai është liruar në maj, nana ime ka ndërru jetë në shtator po të atij viti. Dhe kemi pasë momente tepër t'vështira edhe gjatë ditës së varrimit të nënës time. Nana ka ndërru jetë dikun pasdite nga ora nëntë e gjysëm, të nesërmen në mëngjes janë mbledhë Komiteti Komunal i Lidhjes të Komunistëve të Pejës edhe Lidhjes Socialiste të Popullit të Komunës të Pejës, ku kanë mbajtë një takim dhe është dhanë urdhër që askush t'mos shkoj t'marri pjesë në varrim dhe as në t'pame të gruas të Xhejmajl Gashit, sepse ai është nacionalist, irridentist, antijugosllav e tjerë, e tjerë.

Dhe ditën e nesërme m'kanë ardhë vetëm shoktë dhe shoqet e klasës time të gjimnazit “11 Maji” në Pejë, atëhere quhej “17 Heronjtë” ishte, po pjesa e parë “11 Maji”. Dhe vetëm një mësues nga shkolla filllore e fshatit Tërstenik ku babai im kishte qenë mësues, ku gjyshi dhe xhaxhi im kishin kontibu edhe fizikisht për tu ndërru ajo shkollë. Ku t'gjithë fëmitë ishin me shkollë aty: unë, dy motrat e mia edhe njëri vëlla ishim n'shkollë, sepse vëllai dhe motra ishin shumë t'vegjël, ku fëmitë e xhaxhait t'gjithë ishin n'shkollë aty, dhe nuk kanë leju t'vij asnjë njeri.

Varrimi ka qenë jashtëzakonisht i madh, impresionues, sepse kishte vdekë një gru e re. Nëna ime ka qenë rreth moshës 32 vjeçare kur ka vdekë. Kishte lanë gjashtë fëmi. Unë isha atëherë 14 vjeç e pak, n'qershor kisha ba 14 vjet e ajo vdiq n'shtator. Vëllau i vogël kishte edhe dy javë, Asdreni, për tu bërë dy vjeç. Pra llogarite, ishte një dhimbje e madhe, por edhe n'këtë dhimbje t'madhe UDB-ja me seli në Pejë gjeti mënyrën qysh t'na e nxinte edhe më shumë dhimbjen. Vorrimi i nanës time është kry për dy orë, sepse kanë ardhë policia edhe e kanë marr edhe babain tim edhe mua, për t'na marr n'pytje gjoja për ndonji incident t'paqenë atë ditë, vetëm për t'na nxier edhe më shumë jetën. Kështu që për dy orë është ba ai varrim.

Dhe kjo ndoshta ka ndiku shumë që t'vijne me qindra e me qindra, me mijëra njerëz për ngushllime n'familjen tonë për vdekjen e nënës. E pamja zyrtarisht ka zgjatë për dy javë, por aty ka pasë edhe me muaj që kanë ardhë njerëz për t'na vizitu dhe për t'na ngushëllu, pa marr parasysht presionin e madh që bahej, se rrinin pothuajse me turne në të dy dyqanet, shitoret që ishin n'hyrje dhe dalje t'fshatit, që njerëzit ndalojnë për t'marr cigare, sheqer, siç janë zakonet, kafe e tjera, tjera. Dhe i pysin, "Ku po shkoni?" "Po shkojmë në t'pame." "Jo, po a e dini që ata janë dënu," e kështu. Ka qenë një presion i jashtëzakonshëm pra. I mora këto elemente për t'treguar fëmijërinë, se fëmijëria ime nuk ka qenë e lehtë. Ka qenë një fëmijëri e ngjizur me dhunë dhe me represion, por ndoshta edhe me një ngjizje tjetër: të një etje të jashtëzakonshme për mësim, edhe për një etje të jashtëzakonshme për dashuri për vendin. Kështu ka përfundu shkolla tetë vjeçare.

Jam regjistru në gjimnazin e Pejës. Atëherë ishin të ndara: dy vitet e para ishin t'përgjithshme, ndërsa vitin e tretë e t'katërt kalonin në...

Erëmirë Krasniqi: Në diçka më profesionale?

Flamur Gashi: Më profesionale, po. Pjesa e parë e gjimnazit quhej "17 Heronjtë", ndërsa pjesa e dytë quhej "11 Maji". Këtu fillunë edhe shoqërimet, bashkëpunimet me njerëz, njohjet ma t'mëdhaja, lëvizjet më t'mëdhaja. Ishte një jetë e pas demonstratave të vitit '81, ishin arrestimet e mëdhaja që ndodhnin. Pra po vlonte dhe po ziente gjithçka në Kosovë. Edhe këtu para-adoleshenca, adoleshenca, çdo i ri që ka pak revolucionarizëm në vetvete, fillon edhe interesohet çka po bëjmë ndryshe. Kështu fillon shoqërimi me njerëz t'njejtave mentalitete, t'njejtave ideale, aq ma tepër që ishin edhe lidhjet e babait.

Kështu fillon një jetë e re, një etapë e re, deri n'vitin 1987. Në vitin '87 unë detyrohem që t'shkoj n'shërbim ushtarak sepse ishte një lloj rregulli që nuk mund të vazhdosh studimet pa shku ushtar. Atëherë kjo ndodhi, ndërpritej çdo gjë, shkoje në shërbim ushtarak, e kryeje përreth dymbëdhjetë muaj me frikën e madhe të babait dhe njerëzve që mendonin se a do t'kthehemi gjallë. Sepse ishte koha kur vriteshin, fillunë të vriteshin ushtartë n'shërbimin ushtarak, por akoma nuk kishte marr atë intenzitetin kur vrasja... për fatin tim t'keq unë kam shku ushtar fiks një javë pas krimit të madh n'thonjëza që thuhej se e ka ba Aziz Kelmendi, një ushtar shqiptar, dikun në një kazermë ushtarake, paraqitet në Serbi. Dhe nga aty fillon një dhunë, terror i paparë ndaj t'rinjëve shqiptarë që e kryenin shërbimin ushtarak në ish-Jugosllavi.

Kështu që e kam kry shërbimin ushtarak, jam kthyer, jam regjistruar në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Prishtinë. Pas demonstratave të vitit 1989 jam përjashtuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë sepse nuk u la që t'vazhdonin një pjesë e studentëve. Ishim rreth një qind e ca studentë që u përjashtuem nga fakulteti. Fatmirësisht unë isha i regjistruar paralelisht në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe me korrespondencë dhe kalova pastaj në Gjuhë dhe Letërsi, për t'vazhduar...

Erëmirë Krasniqi: Pse, çka ishte arsyeja që [u përjashtuat]?

Flamur Gashi: Arsyeja ka qenë se në demonstratat e vitit '89 janë përjashtu shumë studentë nga drejta për studim në Universitetin e Prishtinës.

Erëmirë Krasniqi: Pse kanë marr pjesë?

Flamur Gashi: Pse kanë marr pjesë n'demonstrata, shifeshin element rreziku. Une nuk kam pasë t'drejtë sepse për tu vendosur në konvikt duhej t'merrej një leje n'komunë nga vjen, që ti je djalë i mirë apo vajzë e mirë.

Erëmirë Krasniqi: E qysh janë identifikuar?

Flamur Gashi: I ka identifikuar komuna, policia, UDB-ja ka pasë sistemin e vet që dihej rrjeti i tyre. Dhe duhej t'merrsha dokumentin për tu regjistruar n'konvikt. Unë s'kam pasë t'drejtë me u regjistruar n'konvikt. Kanë ndodhë demonstratat e vitit '89, pastaj natyrisht që n'ato demonstrata kam qenë aktiv.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka qenë kauza?

Flamur Gashi: Kauza ka qenë fillimisht në përkrahje të minatorëve të Trepçës. Se u futën minatorët e Trepçës në grevën e urisë, në Stantërg dhe në të gjitha zonat ku kishte minatorë. Dhe ne hymë n'përkrahje t'tyre, u bashkuam. Fillumë fillimisht me demonstrata në të gjitha fakultetet ku ishim, unë isha në Fakultetin e Ndërtimtarisë, për tu ba demonstrata e madhe në sallën "1 Tetori" që është sot. Ishin mbledhë të gjithë studentët dhe filloi greva e studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Kur u ndërpre greva e urisë, pas marrjes me dhunë të kompetencave të Krahinës Autonome të Kosovës nga ana e institucioneve republikane të Serbisë, është ndërpre greva e urisë me dhunë, dhe unë jam arrestuar këtu në Prishtinë nga Policia. Jo vetëm unë, por janë arrestuar me dhjetra e qindra tjerë. Na kanë mbajtur për tri netë në dhomën e policisë këtu në Prishtinë. Na kanë rrafë mirë e mirë, na kanë edukuar mirë e mirë (buzëqeshë). Na kanë lëshu me kushtin që t'paraqitem pas... besoj ka qenë e premtë për tu paraqitë t'hanën. Edhe unë e kam gjetë mënyrën se si... kam ikë në Gjermani. Kam ikë në Gjermani ku kam qëndruar tre-katër muaj, n'fakt kam qëndruar gjashtë muaj. Dhe në tetor kam ardhë prapë, kam filluar studimet, kam filluar prapë, kam vazhduar me aktivitetin tim.

Pjesa e Dytë

[Intervistuesja e pyet folësin rreth rrezikut që kanë ndje anëtarët e familjeve me profil politik nga ana e regjimit serb. Kjo pjesë është hequr nga video intervista.]

Flamur Gashi: Po natyrisht që rreziku çdoherë ka qenë për këto familje, sepse këto kanë qenë në syrin e UDB-së dhe policisë. Dhe kanë qenë lehtë të identifikueshëm djemtë dhe vajzat e këtyre familjeve

Erëmirë Krasniqi: Po de, a ka qenë jetë a vdekje, po mendoj rreziku.

Flamur Gashi: Aty ka qenë një rrezik permanent. Domethanë, ti çdo herë ke qenë tabelë çitje [nën shënjestër] për ta. Ka ndodhë ni rast, për shembull unë e kam pasë njëherë veshur pallton e dikujt tjetër që ka qenë edhe ai i burgosur politik, dhe ka gjujtë n'mu policia duke mendu se është ai. Realisht nuk m'kanë njoftë mu për atë moment. Se ka qenë momenti i tillë që s'kanë mujtë me m'identifiku, po e kishin imazhin e atij me atë pallto, dhe ne n'trup ishim si njejtë edhe me syze. Edhe

ka ndodhë. Çdo herë neve kemi pasë, na ka ndjekë ajo... ndoshta kemi bashkjetu me vdekjen. Sidomos këto familje që kanë qenë të identifikuar që janë kundër sistemit.

Pastaj kanë qenë edhe djemtë dhe vajzat që kanë qenë të organizuar politikisht në grupe të ndryshme marksist-leniniste e tjera. Gjë që unë s'kam qenë i organizuar, t'jem shumë i singertë. Ndoshta kisha mund, por kanë qenë situatat e tilla që s'kam qenë i organizuar. Ata kanë qenë edhe më problematik për sistemin, edhe kanë ardhë më shumë dhe kanë qenë më të rezikum. Këtë kohë kanë ndodhë tri- katër vrasje të rëndësishme në Pejë: është vra Qamil Morina, është vra Ali Hysvukaj, dhe është vrarë Gani Daci. Pse po i potencoj këto tri vrasje? Këto tri vrasje kanë qenë jashtëzakonisht të randa për Pejë se janë plagosur me dhjetra, dhjetra qytetarë të tjerë.

Unë në këtë kohë kam qenë në zonën që quhej Kapeshnicë të Pejës, me një mik timin të ndjerë, një ish i burgosur politik, një djalë i jashtëzakonshëm, i mrekullueshëm, i cili fatkeqësisht është vra në luftën e fundit në Kosovë, është heroi i Kosovës, që është Xhemajl Fetahi nga Raushiqi i Pejës. S'bashku me të kemi qenë në Kapeshnicë dhe kemi pasë, si t'themi, pika të stehimit tonë. Se ishte rrezik edhe ku flenim ne, se ne merreshim me organizimin e demonstratave. Dhe pikat e stehimit tonë, prapë njerëz t'cilët ishin të dëshmuar kombëtarisht dhe politikisht.

Pikën e parë e kemi pasë te shpia e Cufë Sokolit. Cufë Sokoli ka qenë një i burgosur politik që në vitin 1954. Një njeri që kishte provuar burgjet e Goliotokut e tjera në ish-Jugosllavi. Dhe ne n'familjen e tij gjetëm strehim, unë dhe Xhemajl Fetahu. Aty kemi flejtë me netë të tëra. Kemi pasë shtëpinë e zotit Hasan Berisha që kish ardhë dikun nga Krushefcu apo nga Shikësi i rrethit të Baranit, shim vendosë. Një familje e njohur, pra zgjedhëm edhe n'ato familje ku mund t'kishim siguri maksimale në udhëheqjen për demonstrata.

Ndodhën këto tri vrasje. Nuk e di, ndoshta për shkak se unë merresha me shkrime, kisha qejf t'merresha me gazetari, studioja letërsi, dhe donte rasti që të trija këto varrime i kam udhëheqë unë. Pra fjalët kryesore në të trija varrimet, me organizimin e varrimeve merresha unë. Nuk e di pse! Sot me m'pytë, unë nuk e di pse, pse ma kanë ngarku atë detyrë. Tashti mund t'ngris hipoteza çfare të du, por them që ka qenë për këtë punë. Them ndoshta edhe kam pasë ndoj guxim djaloshtar, ashtu t'moshës rinore, kam qenë pak ma... dhe i kam udhëheqë këto varrime. Varrimi i fundit është ba në Nabërgjan, tek xhamia e Nabërgjanit, varrezat e fshatit Lutugllavë-Nabërgjan janë t'përbashkta aty.

Unë e kam udhëheqë varrimin dhe kam pa që para meje kanë qenë tre-katër familje t'hasmume, n'gjak mes veti. Ishte një vajzë e mrekullueshme që fatkeqësisht kishte vrrarë dy vëllezër në vetmbrojtje, për të mbrojtë vëllain e vet dhe babain që... edhe ata dy vëllezër për fatin e zi i kishin çuna t'xhaxhait t'babit, pra ishin kështu familjarisht t'afërt. Kam parë edhe të tjerë, fëmijtë e atyre dy vëllezërve. Ishin ulur një rresht para kësaj.

Erëmirë Krasniqi: Çka thojshit n'ato fjalime?

Flamur Gashi: Këto fjalime ishin mesazhi... këtu desha t'dilja, mesazhi më i madh për qytetarët: se si të bashkohen qytetarët, se si neve t'pajtohemi n'mes vete. Une kam thanë aty që ne duhet t'pajtohemi pa e ditë çka po tham, me t'thanë t'drejtën. Se sot me thanë që kam folë n'atë takim për pajtim t'gjaqeve është absurde. Une kam thanë t'pajtohemi veç se jam nisë se e kam pa Serbeze Vokshin aty dhe kam pa djemtë e atyre dy t'vrrarëve, fatkeqëve, një rresht përpara. Dhe unë e njëfsha familjarisht dhe e dija se janë vra mes vete. Kam pa familje tjetër që kanë qenë t'hasmëruar, po aty. Edhe e kam thanë këtë fjali. Masanej kur e kam pa inçizimin dhe filmimet thojsha, "Po une s'kam ditë çka kam thanë". Dhe realisht nuk e kam ditë çka kam thanë.

Të nesërmen jemi taku në Pejë për tu organizu për demonstratat me këtë grup, me Xhemajl Fetahun, me Have Shalën, Myrvete Dreshajn... kanë qenë ni grup tepër i madh i studentëve që ishim shpërnda nëpër zona t'ndryshme. Dhe jemi takuar në një familje po prap emblematike për rezistencën ndaj sistemit jugosllav, që ishte familja e Din Grabovcit - vëllait të zotit Adem Grabovci, që është kryetar i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës - t'cilin fatkeqësisht forcat serbe e kanë masakru në luftë. Ni burrë i jashtëzakonshëm, ni qëndrestar i jashtëzakonshëm, ni ndihmëtar *par excellence*. Jemi mbledhë aty ne për t'bisedu për demonstrata, qysh t'bajmë, tek... unë kam qenë i rastësishëm aty. Sepse shuimca e tyre ishin ish-të burgasur, të rinjë dhe t'reja ish-të burgosur politik, shokë shumë t'ngushtë mes vete, dhe ndoshta njeriu që ishte pak ma jashtë isha unë. Ju thashë që s'kam qenë i organizuar politikisht.

Ka ra biseda për pajtimin e gjaqeve dhe Have Shala tha, "Une e kam pas ni problem para disa ditëve n'demonstratë me një shok timin t'ngushtë nga Lumbardhi i Deçanit i cili nuk mujti me ardhë n'demonstratë, se m'tha, 'Unë me gjithë qejf do t'vij n'demonstratë, po n'demonstratë vjen edhe filani nga fshati im të cilit babën ia ka vra xhaxhai im. Dhe mu mund të m'kap snajperi ose automatiku i policisë serbe dhe faji ka me i ngelë atij. Unë e dij se ai s'm'vret kurrë por faji ka me i ngelë atij.' Dhe

me lot n'sy nuk erdhi n'demonstratë". Dhe këtu ne çka t'bjamë, si t'bjamë, si t'hyjmë t'pajtojmë... deri atëherë kemi pasë dikun 35 ose 36 t'vrrarë në Kosovë, n'demonstrata dhe n'protesta. Si t'ia bajmë që t'organizohemi që t'pajtohemi? Ka qenë problem sepse n'atë kohë funksiononin n'kuadër të Lidhjes Socialiste të Popullit të ish-Jugosllavisë disa këshilla t'pajtimit t'gjaqeve, të cilat n'fakt shpesh herë ma shumë ngatërronin punë sesa zgjidhnin punë.

Edhe ramë në një ide, sikur t'na ndihmonte dikush prej profesorëve, andej këndeje. Une thashë, "Po une e njoh profesor Canën se merret me këshillin e pajtimit t'gjaqeve". "Dakord, shkojmë bisedojmë e ta". Edhe kështu u vendos që t'vinim në Prishtinë ni grup i studentëve të bisedojmë me profesor Canën. Këtu u mor ni lloj vendimi që t'shkojmë të bisedojmë dikush në Prishtinë. Atë ditë në Prishtinë kam ardhë unë, Serbeze Vokshi...

Erëmirë Krasniqi: Kush është ajo?

Flamur Gashi: Kjo është ajo vajza që kishte vra dy vëllezërit, duke dashtë nga frika që po ia vrasin babain edhe vëllain. Ka ardhë Myrvete Dreshaj, Ibrahim Dreshaj edhe Bajram Kurti. Pra këta ishim pesë të parët që kemi ardhë në Prishtinë. Dhe kemi shkuar te Instituti Albanologjik, jemi takuar me profesor Zekerija Canën. Dhe ngaqë njihesha me profesor Zekerija Canën pak më përpara, kemi bisedu, na ka pritë n'zyrë, ia kam shtrë problemin. Ka thanë, "Flamur, une nuk di t'merrem mirë me këtë punë se unë jam gjakovar, po këtu duhet t'bisedojmë me profesor Anton Çettën." Dhe kemi zbritë n'katin e parë t'Institutit Albanologjik, te zyra e profesor Anton Çettës. Kemi biseduar gjatë e gjerë dhe e kemi lanë me u ritakuar prapë me të. Kam ardhë, jemi takuar me të. Ndërkohë, në terren Have Shala, Adem Grabovci, Xhemajl Fetahaj dhe grupi i të tjerëve n'teren punonin për të organizuar pajtimin e parë.

Erëmirë Krasniqi: Xhemajli, a është mbytë mas takimit?

Flamur Gashi: Xhemajli është vrrarë në luftën e fundit, në Koshare, kur është thy kufiri Shqipëri-Kosovë.

Këtu pastaj, kur kemi bisedu me të edhe e kemi organizu vizitën e parë për me shku në Pejë, kemi ardhë për t'marrë profesor Zeqën dhe profesor Antonin. Atë ditë që e kishim lanë takimin për t'shku në Pejë, kishte vdekë vëllau i profesor Ymer Jakës, Sokol Jaka. Dhe profesor Zekerijaja e kishte të detyrueshme që t'ishte në varrim dhe nuk mundte t'vinte me ne, na ngeli vetëm profesor Antoni. Dhe

përgjatë gjithë kohës jemi interesuar që të gjejmë edhe njerëz tjerë që t'na bashkangjiten aty. Kemi marrë n'telefon disa personalitete, që për shkak të etikës nuk do t'ia përmendi emrin, t'cilët nuk janë bashkangjitur n'këtë aksion. Por i pari që na u ka bashkangjitur ka qenë ni personalitet tepër i lartë të cilin e ka marr profesor Antoni dhe nuk ka dashtë as me ndëgju për këtë punë.

I pari që na është bashkangjitur është Ramiz Kelmendi, profesor Ramiz Kelmendi. Profesor i letërsisë ishte atëhere në Universitetin e Prishtinës, njëri ndër korifetë e gazetarisë në Kosovë, është bërë gati dhe ka ardhë menjherë me neve. Automatikisht ftesën tonë e ka pranuar edhe i ndjeri Azem Shkreli, shkrimtari i njohur dhe Bajram Kelmendi. Gjithashtu ka qenë në këtë grup, ndër t'parët, profesor Mark Krasniqi. Pra kjo është ajo bërthama e parë e intelektualëve nga Prishtina t'cilët iu kanë bashkangjitur pajtimit t'gjaqeve.

Në Pejë ka qenë ni grup tjetër i intelektualëve që veç kishim bisedu me ta, ku ishte avokat Adem Bajri, avokat Mustafë Radoniqi, doktor Mustafë Ademaj, doktor Hysen Mazrekaj. Pra ky ishte grupi, po themi, i intelektualëve të parë që e përkahi iniciativën tonë dhe kështu kemi filluar hapërimin për akcionin e madh të pajtimit të gjaqeve.

Ditën e parë kur jemi nisë në makinë kemi qenë Riza Krasniqi, profesor i gjimnazit t'Pejës i cili kishte makinë dhe n'fakt erdhi për t'intervenuar tek unë për një pajtim, që vëllau i ni profesori tjetër n'gjimnazin e Pejës kishte vra djalin e tezes t'vet dhe don për tu pajtu, se ishte hapë nami se ne do merremi me pajtimin e gjaqeve. Kishte ardhë për këtë punë dhe unë i kërkova ndihmën, meqenëse ai kishte makinë. Unë isha student nuk kisha makinë. Erdhi me makinë dhe n'makinë kemi qenë: Riza Krasniqi si shofer i makinës, unë, profesor Anton Çetta, dhe profesor Ramiz Kelmendi, n'makinën tonë. Në makinën tjerër mas kësaj, Bajram Kelmendi, profesor Marku, Azem Shkreli.

Dhe kur kemi shku në Klinë jemi ndalu te motel "Nora" për t'pi kafe. Kurrë nuk i harroj dy shprehje t'profesor Antonit që m'ka thanë. Dëshprimi im ishte tepër i madh për një profesor që e doja shumë, e admiroja, i cili nuk pranoi as me bisedu me neve për pajtimin e gjaqeve. Edhe unë si i ri, edhe i thashë, "Profesor, unë e admiroj këtë njeri, është shumë i madh." Profesor Antoni m'tha, "Flamur, a e di ku është dallimi n'mes minares t'xhamisë dhe njeriut t'madh, n'pamje t'parë kështu?" S'më kishte shku menja najherë me ba këtë krahasim n'mes minares t'xhamisë dhe njeriut t'madh, thashë, "Jo, professor." Tha, "Minares t'xhamisë sa ma larg t'i rrih duket se po shkon po bashkohet me tokën, duket shumë e vogël. Njeriu që neve i hiperbolizojmë edhe na duken t'mëdhenj, sa ma larg t'i rrih

duket se po e prekin qiellin, që janë t'papakshëm, që janë t'mëdhenj shumë. Kur afrohesh te minarja e xhamisë, sa ma shume t'i afrohesh minares t'xhamisë të duket qe po e prek qiellin, a këtyre njerëzve t'mëdhenj sa ma shumë t'i njohësh, e sheh sa t'vegjël janë". Këtë nuk e harroj kurrë!

Dhe vërtetë pastaj, sa herë kam glorifiku dikend, në mendjen time kam thanë që është i madh ashtu, m'ka ra ndër mend kjo shprehje e profesor Antonit, avash t'i afrohem njëherë, ta shoh a është si minarja e xhamisë apo është si tullumbace e shfryrë, kështu. Dhe shprehja e dytë e profesor Antonit atë ditë, ka qenë, tha, "Flamur leje, po fillojmë këtë akcion për pajtimt t'gjaqeve. Ka shumë rrisqe, shumë rreziqe, shumë sakrifica, po maje n'mend ni gja: duhet t'bash ni kartotekë n'kokën tande. Je ma i riu". "Karotekë? Pse kartotekë, kartoteka mbahet nëpër biblioteka për t'mbajtë shënime cili libër, ku, çka, pse profesor?" "Po nuk patëm sukses, kanë me na sha e nuk kanë me lanë gja pa thanë për neve. Po patëm sukses kanë me na u ngjitë me kucë e me macë, e s'ka me marr vesh i pari t'mramtin as kush ka fillu as kush ka mbaru. Po kryesorja është që t'pajtohen gjaqet. Po ti mbaje kartotekën n'kokë se je i ri".

Vërtetë ndodhi kështu. Akcioni fatmirësisht pati sukses, dhe sot pas 25 viteve dalin njerëz që janë nismëtarë të pajtimit të gjaqeve, që s'kanë qenë kurrë ose kanë ardhë mas pesë-gjashtë muajve, dalin sikur janë prijëtarë, po s'ka rëndësi. E rëndësishme është që akcioni filloi me sukses, iu bashkangjitën shumë njerëz dhe në Kosovë u pajtuan mbi 1600 plagë, vrasje dhe ngatërresa n'mes qytetarëve. Pse e them që pati sukses? Pa akcionin për pajtimin e gjaqeve dhe pa atë frymë bashkuese, kam bindje absolute, që nuk e besoj që jam shumë i gabuar, që shumë ma e vështirë do t'kishte qenë rezistenca nga viti '91 e deri n'përfundim t'luftës '99 në Kosovë. Ky akcion i kompaktësoi shqiptarët, iu dha një frymë tjetër bashkëpunimi për aspiratat që kishin kombëtare.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me na tregu për akcionin, qysh e mbajshit atëherë kontaktin, qysh u organizojshit?

Flamur Gashi: Ne u ndamë pastaj n'grupe. E para, u ndamë n'grupe nëpër qytete. Gjetem shokë tanë. Grupi që ishte i t'burgosurve gjeti shokë e tyre që ishin t'burgosur, po themi në Prizren, në Gjakovë, në Mitrovicë, në Prishtinë e tjera, e tjera. Grupi i studentëve gjetëm grupin tonë. U bashkumë t'gjithë dhe u shpërndamë në terren. Unë kam qenë në Pejë, kam qenë n'akcion në Lipjan, kam qenë n'akcion në Prizren, kam qenë gjithandej. U shpërndamë ku kishim lidhjet tona, që ta përhapshim sa ma shumë këtë punë, këtë akcion. E kontakti i parë ishte që neve shkonim tek ato familjet t'cilat ishin n'gjak, mbledhnim informacionet, dhe shkonim n'shpitë e tyre iu tregonim. E parapërgatisnim terrenin.

Fillimisht pajtimi i gjaqeve u ba në forma individuale. Në fillim fare, me ni gjak, me... pastaj shkoi duke u zgjeru. Gjenim një fshat dhe pajtoheshin dy-tri gjaqe t'njejtin fshat. Për t'ardhë deri tek tubimet e mëdha që u banë për pajtimin e gjaqeve.

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë n'ato tubime?

Flamur Gashi: Absolutisht po! Është ba tubimi i madh në Bubavec, është ba tubimi i madh në Verrat e Llukës, është ba tubimi i madh në Nabërgjan, në Lutogllavë aty te xhamia ku thashë se kam pa ato, qe nuk e disha çka po tham për pajtim, ku janë falë me dhjetra, dhjetra gjaqe. Pra sublimimi i t'gjitha këtyre ishin këto tubimet. Pastaj një grup shkoi edhe në Amerikë në krye me profesor Antonin dhe profesorët e tjerë. [Pajtimet] U bënë edhe në shtetet e perëndimit; u bë një lloj fronti për pajtim; pajtuan njerëzit. Fatmirësisht në ato hapat e parë nuk patëm asnjë hakmarrje që t'na e demotivonte akcionin.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë, të qëndrueshme kanë qenë ato pajtime?

Flamur Gashi: Të qëndrueshme. Mund t'ketë pasë raste sporadike, katër-pesë raste, po themi dhjetë. Po dhjetë raste në 1600 pajtime nuk janë asnjë gja. Dhe kështu që mori hov. Kjo ka vazhdu gjatë gjithë vitit 1990. I ra tempo, ritmi n'pjesën e dytë t'vitit '90, sepse ra intenziteti. Se intenzitet t'madh t'pajtimit kishte ata tre-katër muajt e parë. Pastaj ka vazhdu edhe në vitin '91, po ka qenë ma me avaz.

Erëmirë Krasniqi: Me t'njejtin grup?

Flamur Gashi: U bë... tashti t'gjithë ishin pajtimtarë. U bë frymë mbarëkombëtare. U bë Lëvizje për Pajtimin e Gjaqeve. Kjo Lëvizje për Pajtimin e Gjaqeve identifikohet pastaj me Anton Çettën dhe rininë e Pejës. E kush ishte rinia e Pejës nuk kishte fare rëndësi ma. Kush ishte rinia studentore nuk kishte fare rëndësi ma. Por si plak, si më i mençur, si burrë i odave që ishte mbledhës i folklorit, ishte profesor Antoni. Ni kontribut të jashtëzakonshëm që ne duhet t'i jemi gjithmonë mirënjohës, përveç profesor Antonit, ka dhanë profesor Zekerija Cana.

Profesor Zekerija Cana ka qenë promotor i Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve. Profesor Zekerija Cana ka qenë promotor në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Unë nuk e di, në qoftëse dikush do të shkruante diçka për historinë e Kosovës në fund vitet '80, fillim vitet '90 e Zekerija Cana t'mos jetë

strumbullar i shumë lëvizjeve, besoj që nuk e ka thanë t'vërtetën. Atij njeriu duhet t'i jemi shumë mirënjohës.

Erëmirë Krasniqi: Kujna i janë falë gjaqet, qysh ka qenë ai proces?

Flamur Gashi: Gjaku i falej familjes së dorasit.

Erëmirë Krasniqi: Po, e qysh u mediojke ajo?

Flamur Gashi: Po n'fillim ne patën një përkrahje të mirë, kurrë nuk e harroj kur e kam çu kasetën e parë t'pajtimit t'gjaqeve në Radio Televizionin e Prishtinës, atëhere RTP, kur drejtor i lajmeve ka qenë Veli Vraniqi, një gazetar sporti. Dhe Veli Vraniqi bëri atë që pak kush do ta bënte.

Erëmirë Krasniqi: Kjo ishte Radio Televizioni i Prishtinës, 1990?

Flamur Gashi: Radio Televizioni i Prishtinës, 1990. Akoma nuk ishte marr Radio Televizioni i Prishtinës nga policia serbe. Dhe Veli Vraniqi e gjeti mënyrën qysh m'u transmetu ky lajm: e dha në lajme, dhe kurrë nuk e harroj Violeta Rexhepagiq, atëherë ishte përgjegjëse për transmetimet nga jashtë, diçka t'tillë, dhe Violeta Regjepagiq ia ka dhanë mediave të huaja këtë kronikë të pajtimt të gjaqeve. Fatmirësisht këtë kohë e ka mbajtur dhe e ka filmuar mirë regjisori i ndjerë Fahri Hysaj. Është marrë n'atë kohë regjisori Fetah Mehmeti, është marrë n'atë kohë gazetari Nezir Istrefi, që ishin... ka shkruar Mehmet Kajtazi, ka shkruar Skënder Zogaj në "Rilindje".

Erëmirë Krasniqi: A pati konsekuenca për zotin Veli Vraniqi?

Flamur Gashi: Po, pastaj u mbyll Televizioni i Kosovës. Zoti Veli Vraniqi ishte tip pragmatist, e kalonte... ishte një humorist i jashtëzakonshëm, e kalonte me pak pije, por ai ka qenë i pari që e bëri. Dhe na e ka dhanë ni ndihmë të jashtëzakonshme dalja e lajmit që ka fillu akcioni për pajtimin e gjaqeve në Kosovë. Ni ndihmë të jashtëzakonshme! Duhet t'i jemi mirënjohës atij edhe Violeta Regjepagiqit dhe gjithë këtyre njerëzve, gazetarëve tjerë që i kërkoj ndjesë që nuk po i përmendi t'gjithë me emra, se është ni listë e gjatë e këtyre njerëzve që na u bashkunë dhe shkrunë. Atëhere u ndërpre "Rilindja", shkruante gazeta "Bujku", shkruante "Fjala", shkruante "Bota e Re", shkruante "Zëri" që ishin gazetatat tjera. Dhe shkruante "Alternativa" që doli në Lublanë, dhe shumë e shumë gazeta që ... te Radio Prishtina që transmetonte vetëm pesë minuta në kuadër të Radio Zagrebit.

Erëmirë Krasniqi: Qysh është reprezentu n’media?

Flamur Gashi: Aksioni i madh për Pajtimin e Gjaqeve; akcionit po i prinë profesor Anton Çetta, mbledhësi i folklorit, studiues i mirë. Prezantoheshin që po merrnin pjesë personalitetet më të njohura të shkencës, kulturës, artit në Kosovë. U bashkunë që n’javën e dytë-tretë intelektualët ma t’njohun të Kosovës. Pastaj... se në njanën anë ishin lëvizjet politike, që vazhdonte n’krye me Ibrahim Rugovën Lidhja Demokratike e Kosovës, dhe po krijoheshin parti çdo ditë e ma shumë, dhe këtej ishte akcioni për pajtimi e gjaqeve. Pra kishte një lloj të themi kështu pluralizmi n’mendim dhe veprim. Gjithkush donte t’bëhej i rëndësishëm dhe t’kontribonte diçka. Ishte një frymë e cila po mobilizonte forcat shqiptare n’Kosovë, drejt lirisë dhe pavarësisë t’Kosovës.

Erëmirë Krasniqi: A paraqitej kështu n’media?

Flamur Gashi: Atë hapësirë që kishte po, patjetër. Atëherë nuk kishte *facebook*, nuk kishte *twitter* dhe nuk kishte rrjete sociale, as *viber* as *what’s app* që t’merreshim vesh mes vete. Por sistemi më i mirë ishte që kjo shkonte gojë më gojë, vesh më vesh. Jehona ishte e madhe. Dhe në këto raste reklama më e mirë dhe media më e mirë janë njerëzit e kënaqur. Siç është në *multilevel marketing*, që thuhet blerësi i kënaqur është reklama më e mirë, edhe këtu njerëzit e kënaqur dhe kjo veprimtari ishin reklama më e mirë për punën tonë.

Erëmirë Krasniqi: Kjo inspiroi edhe shumë njerëz me e falë gjakun, a po?

Flamur Gashi: Absolutisht! Kjo i motivoi njerëzit me e falë gjakun. Edhe ishte një shprehje e profesor Anton Çettës kur thoshte, “Burrni është me falë, jo me vra. I fortë është ai që falë, jo ai që vret”. Edhe vërtetë, vetëm ai që nuk e ka provu, se gjë më t’vështirë se me falë nuk ka. Sidomos me falë gjakun e motrës së vet, të vëllaut të vet, të fëmisë së vet, të vajzës së vet. Është e tmerrshme! Madhështia në pajtimin e gjaqeve ka qenë e atyre që kanë falë. Ne kemi qenë në momentin e duhur, në kohën e duhur disa promotorë dhe shërbëtorë që ndoshta e kemi futë ingranazhin të funksionoj. Por madhështia iu qëndron atyre që kanë falë.

Ne na ka gjetë momenti historik, na ka futë n’atë kohë. Por ata njerëz që e kanë falë gjakun e vëllait t’vetëm... ka pasë dy motra që e falshin gjakun e vëllait t’vetëm, ose ni motër që falte gjakun e vëllait ose ka pasë babai që falte gjakun e djalit t’vetëm që e ka pasë, s’kishte as vajzë as djalë më. Është e tmerrshme! Dhe si thoni, djali i vëllait ose i motrës thotë, “Falë i qoftë Kosovës.” Sa madhështore! Se

duket folklorike ajo, për brezat e ri duket shumë folklorike, por atëherë ishte tepër madhështore. Vendoseni çdo gja n'konteks kohor para 25 vjetëve, dhe vendoseni çdo gja kur dhuna dhe represioni i Serbisë po shtohet dita më ditë në Kosovë.

Erëmirë Krasniqi: A keni pasë pengesa prej policisë?

Flamur Gashi: Absolutisht, sa t'dush, sa t'dush. Pengesat ishin t'gjithëanëshme; përveç pengesave fizike që bënin... ja ka qenë rasti kur u mbajtë tubimi te Verrat e Llukës. Profesor Zekeria Cana dhe unë kemi qenë t'arrestuar nga policia në Deçan.

Erëmirë Krasniqi: Sa ju mbajtën?

Flamur Gashi: Jemi mbajtë pesë-gjashtë orë derisa u bo protesta edhe na lirunë se e rrethunë stacionin e policisë, se ishin me mijëra e mijëra, qindra mijëra njerëz ishin n'protestë... në tubim t'Verave t'Llukës. E morën vesh edhe e rrethunë policinë.

Erëmirë Krasniqi: Ajo protestë... po mendoj Verrat e Llukës ka qenë e lajmërume, a po?

Flamur Gashi: S'kishte rëndësi që ishte e lajmërume po të mbledhen pesë-gjashtë qind mijë vetë, një milion vetë... A e din çka do të thotë pesë-gjashtë qind mijë vetë me u mbledhë, një million vetë m'u mbledhë? Edhe me e kujtu edhe ni datë historike ku ishin pajtue përpara te Verrat e Llukës shqiptarët. Ishte e tmerrshme për Serbinë. Pastaj ishte një mrekulli kur në këtë akcion për pajtim t'gjaqeve ishte një gërshetim i t'rinjëve me t'vjetrit, i studentëve me intelektualët, i vajzave me djemtë, i grave me burra, i prijësve fetarë. Ndhimesë të jashtëzakonshme kanë dhanë prijësit fetarë në pajtim t'gjaqeve.

Nuk duhet t'harrojmë asnjëherë ni kontribut t'jashtëzakonshëm që ka dhanë Mulla Idriz Kukrruku, një hoxhë i cili punonte në Arkivin e Kosovës, imam Mulla Xhevat Kryeziu, hoxha i Bubavecit t'Malishevës. Nuk mund të lihet [anash] ndihmesa e jashëzakonshme e dy prijësve fetarë, qoftë atij katolik, qoftë atij të Bashkësisë Islame të Kosovës: doktor Rexhep Boja dhe ipeshkvi i ardhshëm i Kosovës, Imzot Mark Sopi. Fryma pozitiviste që n'fillim t'pajtimit t'gjaqeve prej njërit prej korifeve të fesë dhe t'kombit në Kosovë, Imzot Nikë Prela, që ishte ipeshkvi i parë i Kosovës, para Imzot Mark Sopit. Ka qenë e jashtëzakonshme! Këto ishin që na ndihmunë shumë. Na ndihmunë të theheshin barrierat edhe fetare.

Erëmirë Krasniqi: Po nuk ka pasë gjaqe ndërfitare?

Flamur Gashi: Ka pasë gjaqe, si s'ka pasë, ka pasë. Gjaqe ndërfitare ka pasë dhe ka pasë edhe pajtesa nga këto gjaqe ndërfitare. Dikun në vitin '89-90 ka pasë... para se t'filloj akcioni për pajtimin e gjaqeve... shife, historia nuk ka fillu me ne, pajtimi i gjaqeve nuk ka fillu me neve. Pajtimi i gjaqeve ka ekzistuar gjithë kohën te ne, por n'kohën që u morën ne me pajtimin e gjaqeve mori formë tjetër, mori përmasa tjera. Ka pasë pajtimtarë t'gjaqeve t'jashtëzakonshëm Kosova. Ka qenë Mulla Zekë Bërdyna, ni i burgosun politik në Goliotok, ni personalitet n'rrashfin e Dukagjinit që është marr me pajtimin e gjaqeve; Ramadan Shabani i Kievës, Mujë Loshi. Ka pasë personalitete t'ndryshme që janë marr me pajtimin e gjaqeve. Por, kjo erdhi duke u frymëzuar ndryshe.

Kemi pasë ne... thirrja e parë për pajtim t'gjaqeve nuk ka fillu me ne, nuk ka fillu me mu që e thashë çka kam folë atje. Thirrje për pajtimin e gjaqeve kanë ba minatorët e Trepçës në Stantërg. Janë pajtu tri gjaqe me thirrjen e tyre. Por nuk eci, nuk mori jehonë. N'atë kohë kanë qenë dy prijës fetarë që kanë ndikuar për pajtim t'gjaqeve: Muhamed Lipa, hoxha i Baranit dhe prifti i Glllogjanit Don Anton Kçira, që kanë ndiku n'pajtim n'mes familjeve muslimane dhe katolike. Pra, këtu ishte madhështia. Që aty nuk shifej as kush është nga qyteti, as kush është nga fshati, as kush është katolik, as kush është musliman, as kush është nga rrafshi i Dukagjinit, as nga Drenica. Mori përmasa kombëtare.

Erëmirë Krasniqi: E qysh u fitu krejt ky besim? Ju na tregutë që paraprakisht ka ekzistuar edhe ni përvojë e keqe, ku ka ekzistuar ni komisioni i pajtimit t'gjaqeve, ku ka pasë t'përfshimë edhe nga UDB, që ma shumë kanë kriju telashe se sa që kanë bo pajtime. Po mendoj, qaj tranzicioni prej ni përvoje t'keqe...

Flamur Gashi: Besimi u krijua sepse e mori n'dorë rinia dhe nuk kishte interesa. Çfarë lloj interesi mund t'kisha unë n'pajtim në një familje n'Kaçanik, interes personal? Aty ku nuk ka interes personal, aty ku nuk ka interes material, kryhen puntë. Rinia nuk kishte as interesa personale as materiale. Ne ecshim me orë të tëra n'kambë me shku me lutë dikend me falë gjakun, që as s'e njifnim as s'e dinim. Po ne këtë ia kërkonim për hirë t'rinisë t'Kosovës, për hirë të fateve t'Kosovës, për hirë t'bashkimit tonë. Dhe ata e shifshin që s'jem... ne ndodhte që s'e njifshim, s'e dishim kush është ai që e ka vra. Pra, s'kishim asnjë lloj lidhje me palët n'konflikt.

Në qoftëse neve do t'kishim lidhje me palët n'konflikt, atëherë mund t'baheshim palë me dikun [të anojmë në proces]. Mund t'akuzoheshim se qe po e kryjmë për atë... po ne ishim t'ri, ne qëllim kishim vetëm pajtimin, ne qëllim e kishim vetëm ndaljen e vëlla-vrasjes edhe të hakmarrjes. Pse? Hakmarrja

dhe gjakmarrja ndodhë aty ku nuk ekziston shteti. Kur shteti me mekanizmat e veta nuk funksionon, atëhere merret n’dorë vet gjyqësia. Shtetit me mekanizmat e veta në ish-Jugosllavi nuk i interesonte që t’i zgjidhe këto probleme, që t’i gjykonte drejt dorasin ta gjykonte për vrasje, por shteti e dënonte katër-pesë vjet, lëshohej nga burgu ai që kishte vrarë një djalë 27-28 vjeç. Kështu që familja nxitej n’tjetrën anë që t’hakmerrej. Kështu ndodhte.

Dhe në këtë moment, në këtë zbraztirë ndodhi ky fenomen, që për mu është mrekullia e vetme shqiptare. Unë e kam thanë edhe një herë tjetër, po e përsëris edhe sot: do t’isha ndër njerëzit ma t’lumtur n’botë në qoftëse vetëm një njeri ka shpëtu pa u vra prej punës sime që kam ba n’pajtimin e gjaqeve, lere ma më shumë, sepse ju nuk e keni përjetu. Por nuk e dini se sa shumë shkëlqim n’sy dhe n’fytirë shifje tek ata njerëz t’cilët pajtoheshin. Nuk çliroheshin vetëm ata që mund t’vriteshin, po shumë çliroheshin edhe këta që e kishin rradhën për t’vlarë.

Pse? Këtu pati edhe keqinterpretime të Kanunit. Kanuni i Lekë Dukagjinit është ni mrekulli në vetvete, për kohën kur është shkruar dhe për kohën kur ka funksionuar. Por ta marrësh dhe ta impostosh Kanunin e Lekë Dukagjinit për pesë qind vjet n’kohë, është absurditet, një krim. Dhe këto që merreshin gjoja me pajtimin, e interpretonin në mënyrë të gabuar Kanunin. Sepse Kanuni e ka shumë të qartë që vritet dorasi, ai që vret vritet. Pse e thotë kështu? Sepse e ndalon atë tjetrin me vra, “Në qoftëse vret ti, dije që ke për tu vra edhe vet”. Kjo është një masë preventive për të ndaluar hakmarrjen. Ndërsa e interpretonin ndryshe, “Duhet vra mashkullin ma t’mirë...” e ku e di unë se çfarë. Prandaj lirimi shpirtëror ishte i jashëzakonshëm te ata që falnin.

Erëmirë Krasniqi: Sa ishin t’vjetra rastet e hasmërisë?

Flamur Gashi: Ka pasë raste edhe të fillim shekullit, ka pasë raste 50 vjeçare, 60 vjeçare. Ka pasë raste një qind vjeçare që ka shku element zinxhir, duke u multifiku, duke u shumu ai. Ka pasë raste pse ia kanë vra gjyshen, e kanë vra djalin 25-gjashtë vjet. Domethanë, gjithçka kishte. Fatkeqësisht kishte gjithçka. Për fatin tonë t’keq e t’zi, kishte gjithçka. Por, ka edhe fate n’fatkeqësi. Fati i madh ishte që rinia e mori këtë akcion, u mbështet në mënyrë t’padiskutueshme nga shtresa më e mirë e intelektualëve t’Kosovës edhe akcioni pati sukses.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin prej akcioneve janë falë ma s’shumti gjaqe?

Flamur Gashi: Te Verrat e Llukës.

Erëmirë Krasniqi: Sa?

Flamur Gashi: Kanë qenë mbi dyzet e sa gjaqe e ngatërresa. Mori formë atëherë, mori jehonë tjetër.

Pjesa e Tretë

Flamur Gashi: Gra t'reja që i kanë rritë fëmijtë jetima, nuse 22-tri vjeçe që është detyru përjetësisht t'veshi rrobat e zeza, t'vej zi edhe n'shpiirt, e t'rrisë fëmijtë se iu ka vra burri. Po ma e vështira, ma e randa ka qenë që kjo përveç që iu ka vra burri, në nënvetëdije tanë kohën e ka pasë që edhe djali i saj tash duhet me e vra dikan tash, me e nxjerrë hakun e burrit. Edhe fëmijtë janë rritë me atë trauma se nesër duhet me u ba vrasës. Se morali, konteksti i moralit e ka dashtë që duhet me e nxjerrë gjakun. Po shife, është rritë një shoqëri e traumatizuar me konceptin, po s'vrava, t'vrasin. Dhe po s'vrave, ti nuk je i denjë për shoqërinë: s'ke nxjerrë hakun e vëllait, s'ke nxjerrë hakun e xhaxhait, s'ke nxjerrë hakun e babës. Dhe kështu kanë marrë përmasa tjera gjaqet. Kështu pastaj s'ke pasë fshat, s'ke pasë fis që nuk ka pasë... në një kohë...

Nuk thashë në fillim për Lidhjen Socialiste, kanë qenë edhe ndërhyrje t'jashtëzakonshme edhe të UDB-së jugosllave. Që thamë, kur nuk funksionon shteti, atëherë është vetëgjyqësia. E vrisje njeriun, binte n'burg ky, familjes së tij i afrohej dikush nga UDB-ja i thoshte, "Shife, ata kanë me ju vra se janë shumë t'fortë. Ju duhet me marrë ni pistoletë, me ba diçka në qoftëse dojnë me t'vra." Ia jepnin pistoletën atij, e armatosnin, ia jepnin edhe me leje. I merrnin edhe pare për atë punë, e shfrytëzonin. Tjetërkush shkonte i thoshte këtyre, "Shife, ata t'rrezikshëm, se ata e kanë lidhjen me policinë edhe dojnë me e nxjerrë [hakun] ata. Kini kujdes, se ata iu vrasin apet". Edhe atje merrshin para, edhe atyre iu jepshin pistoletë. Pra, i ngatërrojnë në të gjitha anët punët, vetëm që t'mos kishte pajtim n'mes shqiptarëve.

Vlente teoria latine: përçaj e sundo. Këtu i përçante shqiptarët, për t'i sunduar shumë më lehtë. Dhe metoda më efikase ishte gjakmarrja dhe vëlla-vrasja tek shqiptarët. Fenomen i cili mori përmasa t'jashtëzakonshme. U shtri shumë edhe u ba një kancer për shoqërinë shqiptare në Kosovë, kancer i cili po shtrinte metastazat e veta me një shpejtësi t'rrefeshme. Derisa filloi ky ekzod, n'fillim t'vitit '90 që i këputi këto tentakulat, i ndërpreu metastazat, dhe shqyrr Zotit e shëroi shoqërinë, shoqërinë shqiptare në Kosovë.

Sa here t'i themi "Faleminderit" atyre intelektualëve, atyre studentëve, por mbi t'gjitha atyre njerëzve që falën gjaqet, është pak. Këta burra dhe gra, që kanë gjetë kurajon, kanë gjetë forcën shpirtërore... unë nuk e di, nuk e di ku e kanë gjetë atë forcën që i kanë falë gjaqet, por kanë qenë me një forcë të jashtëzakonshme. Mund t'jetë edhe forcë e mbinatyrshme, që vetëm një herë vjen e s'vjen ma. Shumë e vështirë. Shpresoj t'mos i bie kurrkujt ta provoj sa e vështirë. Se duhet me e çitë dorën n'zemër çdonjëri edhe me thanë, "Po mu në qoftëse m'ndodhë, çka baj?" Nuk e di!

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi me jetën e juje mandej? Për juve, kur përfundoj pajtimi po mendoj?

Flamur Gashi: Për mu pajtimi i gjaqeve ka përfundu dikund në vjeshtën e parë të vitit '90. Pata shumë problem me policinë, për gjashtë muaj, nga maji i '90-tës, n'fakt nga prilli i '90-tës kur dy miqë t'mi edhe bashkëpunëtorë t'mi t'ngushtë u vranë në Lazarevë, Nuriye Zekaj nga Raushiqi i Pejës, studente, bashkëveprimtare në akcionin për pajtimin e gjaqeve dhe veprimtari i njohur Naser Veliu nga Sërmënova e Gostivarit, i cili jetonte në Zvicër. Filloi një etapë tjetër për mua, një përpjekje permanente e policisë, kërkim për arrestim, bastisje n'shpi, kontrole nëpër vendet ku rrija unë, nëpër shpiat ku rrija unë. Dhe për gjashtë muaj, baba im ka qenë i detyruar që çdo t'hane dhe t'premtë, n'ora dy, t'paraqitej n'polici, t'jepte llogari se ku jam. Shumë e vështirë!

Momentin e fundit kishim qenë me profesor Zekeria Canën në një varrim në Kaçanik, të një ushtari që ishte vranë. Une kisha mbajtur fjalë rasti n'atë varrim. E kishte dhënë "Zëri i Amerikës" një pjesë të fjalës sime, "Radio Zëri i Amerikës", dhe t'nesërmen e kanë marr babain në polici. Dhe një bashkëpunëtor, ishte drejtusë i UDB-së jugosllave atëhere, Demë Muja në Pejë, i cili ka ikë, jeton në Serbi a në Mal të Zi dikun, që ishte shumë famëkeq n'rrafshin e Dukagjinit, i thotë, "Une e di ku është Flamuri dhe kam me vra." Babait tim. Ky thotë, "Okej, nëse ti paske me e vra edhe unë po e di se kush ka me vra djalin tim". Marr vesh une nga baba, kështu, kështu. Baba ish shumë i shqetsumë, i alarmumë, edhe me t'thanë t'drejtën kur e mendoja takimin tim me babën n'vitin '84, kur nuk e kam njoftë, e kisha shumë të vështirë që ta imagjinoja që baba im t'jetë prapë në një gjendje të tillë edhe fizike, edhe psikike, torturat, e t'gjitha. Dhe kam shku në Shqipëri. Vizita ime e parë në Shqipëri ka qenë me 2 korrik t'vitit '90. Jam kthi nga Shqipëria n'Kosovë, dhe në fund të tetorit, 5 tetor, kam ikë në Gjermani.

Erëmirë Krasniqi: Qysh mujshitet me qarkullu për Shqipëri, a s'ka qenë atëhere e ndalume?

Flamur Gashi: Jo, ka qarkullu atëhere përmes Maqedonisë edhe Greqisë. Se shkohej, kishte një linjë që shkonin për Selanik autobusat. Ka qenë ni agjenci turistike te “Tre Sheshirat” e ka pasë zyrën. Aty e dorëzoje pashaportën edhe t’merrnin ata vizën në Shkup. Ka qenë një linjë interesante shumë. Por me 1 korrik janë heqë vizat hyrëse për shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërie, në Shqipëri, se deri atëherë është dashtë me pasë vizë për me hy në Shqipëri. Dhe une me 2 korrik kam hy. Fatkeqësisht ka qenë një ditë e tmerrshme 2 korriku.

Erëmirë Krasniqi: ‘91?

Flamur Gashi: ‘90, ‘90. Se ka qenë dita e ikjes t’madhe t’shqiptarëve të Shqipërisë përjashtë.

Erëmirë Krasniqi: E ju hyjshit mrenda?

Flamur Gashi: Unë hyjsa mrenda. Kam ndejtë dy javë, jam kthy, por prapë nga Greqia. Kam ardhë në Kosovë, ilegal poshtë e përpjetë. Me 5 tetor jam detyruar t’iki, kam shku në Gjermani. Nuk kam mujtë me jetu në Gjermani, edhe pse mu m’dhanë menjherë strehim politik, e azil, e ku e di çfarë. Me 18 janar të vitit ‘91 kam shku në Shqipëri. Dhe që nga 18 janari i vitit ‘91 jetoj, studioj, punoj dhe veproj në Shqipëri.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me na folë për jetën profesionale atëherë?

Flamur Gashi: Në vitin ‘91 kur kam shku une, ka qenë vit i ndryshimeve t’mëdha, protesta, demonstrata. Në shkurt është rrëzu përmendorja e liderit komunist Enver Hoxha, ndryshimet e mëdha demokratike, krijimi i partive të ndryshme pluraliste. N’vitin ‘92 bahen zgjedhjet e para pluraliste dhe demokratike në Shqipëri. Menjëherë pas këtyre zgjedhjeve unë angazhohem dhe punoj fillimisht si bashkëpunëtor dhe gazetar në gazetën “Kosova”.

Erëmirë Krasniqi: Botohej në Shqipëri?

Flamur Gashi: Botohej në Shqipëri nga shoqata “Kosova”. U bë një shoqatë e kosovarëve që jetonin në Shqipëri, e nxorrën një gazetë, dhe unë bashkëpunoja me ta. Dhe n’fund t’vitet ‘92, fillim t’vitet ‘93 kam fillu me punu në Radion Televizionin Shqiptar si bashkëpunëtor i jashtëm, për t’punu si gazetar, e deri drejtues i radios. Unë jam angazhuar në media kryesisht në Shqipëri, prej vitit ‘92 e deri në vitin 2005 kam qenë aktiv në media. Kam vazhdu edukimin prap, studime të thella për ta pa veten se ku je, sepse ishte një ndryshim mentaliteti, shkollimi, leximi. Sepse kishte mungesë leximi me t’thanë

t'drejtën. Kur merresh me aktivitete shumë nuk ke kohë me lexu. Këtu mendoja se po lexoja shumë. Unë realisht lexoja, por kur kam shku atje e kam parë se sa pak kam lexu. Edhe i kam rihyrë edhe një herë me thellësi gjërave t'i lexoj, dhe kështu ka vazhdu kjo punë.

Për një kohë pastaj, në vitin '97, kur fillunë rrëmujat e mëdhaja, une isha gazetar, kam filluar dhe jam zgjedhur kryetaredaktor i radios së parë shqiptare në Shqipëri, private, radios t'parë private në Shqipëri, "Radio Kontakt". Ishte e çuditshme që unë isha i lindur në Kosovë, dhe për herë t'parë ndoshta drejtuesi i një medie në Shqipëri u ba një shqiptar nga Kosova, që thyheshin ca barriera.

Atë kohë filloi organizimi ushtarak në Kosovë. Unë për nga natyra jam institucionalist, domethanë e du shtetin shumë dhe funksionimin e tij. M'u kërkua nga pjestarë të qeverisë së Kosovës që t'angazhohem. Jam angazhuar vetëm në Tiranë duke qenë në Tiranë, në qeverinë e Republikës së Kosovës që atëherë udhëhiqej nga presidenti Rugova, kryeministër ishte zoti Bukoshi. Kam qenë këshilltar i ministrit për Informata të Republikës së Kosovës, zotit Xhafer Shatri.

Kam punuar si drejtues i projektit për krijimin e Radio Televizionit të Kosovës, që duhej t'bëhej diku n'diasporë. Nuk pati sukses ajo punë për shkak t'rrethanave, t'kushteve, që s'donte askush ta merrte përsipër atë punë, e tjerë. Dhe pas punës së këshilltarit të ministrit t'informatiave të Republikës së Kosovës, zotit Shatri, kam qenë deri në demobilizim këshilltar i ministrave të Mbrojtjes të Republikës të Kosovës. Fillimisht këshilltar i kolonel Ahmet Krasniqit, një njeri i jashtëzakonshëm dhe një shkrimtar i jashtëzakonshëm, i cili u vra fatkeqësisht në Tiranë. Pastaj edhe i ministrit të Mbrojtjes të Republikës të Kosovës, gjeneral Halil Bicaj. Kur është kry lufta në Kosovë...

Erëmirë Krasniqi: Kjo ka qenë në '98?

Flamur Gashi: Deri 2000-shin kur u demobilizu '99-2000 kur...Unë kam nejtë gjithmonë në Tiranë, kam funksionu në Tiranë, nuk jam shkëputë nga mediat. Kam ardhë mas lufte në Kosovë ni vit, nuk kam... jam kthi në Tiranë, kam vazhdu punën. Kam vazhdu drejtor i "Radio Kontaktit", pastaj kam qenë përreth dy vite në Bordin e Mediave, bashkëdrejtues i Bordit të Mediave të Republikës të Shqipërisë.

Dhe në vitin 2005 kam kaluar në diplomaci. Nga viti 2005 dhe sot jam pjesë e diplomacisë aktive të Shqipërisë. Deri në vitin 2010 kam qenë drejtues i Institutit Kombëtar të Diasporës Shqiptare në Ministrinë e Punëve të Jashtme, si drejtor i këtij instituti. Në 2010-tën, fat apo fatkeqësi nuk e di, jam

zgjedhë, jam emëruar ambasador i jashtëzakonshëm me fuqi t'plotë i Republikës të Shqipërisë në Bosnje dhe Hercegovinë. Fatkeqësisht, më takoi mua t'jem ambasadori i parë i Shqipërisë i lindur në Kosovë. Nuk e di, drejtues i parë i medias së lirë i lindur në Kosovë, ambasadori i parë në Bosnje i lindur në Kosovë, nuk e di...

M'ka njëkë nifarë fati kështu, që t'jem në disa gjana pa dëshirën time, pa vullnetin tim, por ka ndodhë që është ashtu. Kam punuar për rreth pesë vjet në Bosnje dhe Hercegovinë, katër vjet e nëntë muaj, rreth pesë vjet. Dhe nga 1 tetori i vitit t'kaluar, të vitit 2015, m'fal 2014 jam këshilltar diplomatik për rajonin i presidentit të Republikës të Shqipërisë, zotit Bujar Nishani, dhe njëkohësisht ligjërues në Universitetin AAB në Prishtinë. Në sferën time të ngushtë ligjëroj kryesisht landët e diplomacisë: Bazat e diplomacisë, Të drejtën diplomatike konsulore, Bazat e protokollit, Negociatat dhe zgjidhjet e konflikteve, kështu. Edhe në landë që e kam shumë për qejf, që e du shumë: Marrëdhënie publike.

Në Shqipëri kur kam shku pastaj si gjithë të tjerët kam kriju familjen edhe unë. Jam martuar në vitin '98 me zonjën time që quhet Aida, është juriste e diplomuar. Kam tre fëmijë, që për shkaqe, motive, ndosha edhe iu ka vu emra që lidhen pak ma shumë me Kosovën sesa me Shqipërinë. Vajza e madhe e ka emrin Ulpiana, që në Shqipëri është emër i rrallë. Këtu pak ma shumë sepse jemi edhe n'lagjen Ulpiana (qeshet), e kemi këtu Ulpianën afër, por atje ishte si emër ekzotik, kështu pak. Vajza e dytë është Kaltrina. Ulpiana është 17 vjeçe, Kaltrina është 15 vjeçe, dhe e kam Jonin shtatë vjeç.

Edhe në figuracionin tim psikik kështu jam mundu që t'i lidhë Ulpianën me Jonin dhe me Kaltërsinë e qiellit (qeshet). Ka ndodhë sepse kështu ka bërë edhe babai im. Është e çuditshme, emrat e fëmijëve të ne, vetëm une e kam ndryshu, e kam me "F", t'gjithë tjerët e kanë me "A". Motra ime quhet Afërdita, e dyta; Ardita është e treta, Arbeni është vëllai im, Arjeta dhe Asdreni. Dhe ti i lidhë Flamuri, Arbëri, Asdreni. Kështu që, këtu janë ba disa kombinatorika (qeshet). E çuditshme, pa dashje ndoshta, por ata para neve edhe e kanë bërë kështu me dashje.

Por duhet t'iu jemi shumë mirënjohës, shumë mirënjohës sepse po t'mos kishin qenë prindërit tanë që na kanë eduku dhe na kanë mbushë me këtë dashuri për vendin, për qytetarët, për Kosovën, për Shqipërinë... duhet t'iu jemi shumë mirënjohës prindërve tanë sepse ata kanë vujtë shumë. Ne nuk mund ta konceptojmë se çfarë vuajtje kanë kaluar ata për shkollim, për dije, për t'na shkollu neve. Ne sot në këtë Kosovë të lirë, në Shqipëri të lirë, dhe me këto kushte që kemi, t'gjitha mundësitë e

shkollimit, edhe shife çka po heqim, lëre ma nën ni trysni. Por etja e tyre për liri, për dije, për shkollim, për ni t'ardhme sa ma t'mirë t'fëmive, na ka bo edhe neve ma shumë të përkushtumë.

Është fat që populli shqiptar kudo që është po i rritë brezat e rinjë t'edukumë, t'emancipumë, me ni traditë t'shkollimit tashti. Në qoftëse n'familjen time i pari që kishte kry shkollën është babai im, tashti te fëmitë e mi është ndryshe. Merreni me mend se si do të jetë te fëmitë e tyre, kur dikujt do t'i thonë babai im ka qenë ambasador, ka qenë profesor universiteti, gjyshin e kam pasë mësues. Domethanë, fillon tradita tek të gjithë ne. Fatkeqësisht neve këtë traditën e edukimin dhe shkollimit nuk e kemi pasë, për fatin tonë t'keq. Shumë t'pakta kanë qenë ato familje që kanë ni traditë në shkollim, maksimumi shkojmë deri te gjyshi. Edhe kjo kur shkojmë deri te gjyshi n'raste fatlume. Po them për brezat e mi, se tashti brezat e rinjë shkojnë edhe ma larg. Por për brezat e mi të kishe edhe gjyshin e shkolluar ishte rast fatlum, tepër i madh. T'kishe nanën që kishte kry shkollën, unë po them që nana ime ishte me shkollë t'mesme, ishte fat i madh n'atë kohë. Dhe sot t'mos e këtë nana fakultetin është pak jo fort mirë. Kështu qe kështu shkon jeta.

Erëmirë Krasniqi: Shumë faleminderit!

Flamur Gashi: Faleminderit juve!